

THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME PËR PËRFAQËSIMIN E SHQIPËRISË NË EDICIONIN E 56-TË TË EKSPOZITËS NDËRKOMBËTARE TË ARTIT NË VENECIA

Ministria e Kulturës së Republikës së Shqipërisë shpall thirrjen për projekt-propozime për pavijonin e Shqipërisë në Edicionin e 56-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit në Venecia, që zhvillohet në datat 9 maj – 22 nëntor 2015 dhe kurohet nga Okuwi Enwezor.

Kjo thirrje do të qëndrojë e hapur deri më 30 shtator 2014.

Thirrja e Ministrisë së Kulturës për përfaqësimin e Shqipërisë në këtë eveniment është për propozime kuratoriale paraqitur nga një, apo më tepër kuratorë dhe ku përfshihen një, apo më shumë artistë. *Kuratori (ose kuratorët) dhe artisti (ose artistët) duhet të jenë bartës të një projekti të përbashkët që përfshin prodhimin e një ose më shumë veprave të reja posaçërisht për Edicionin e 56-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit në Venecia.*

PËR PROFILIN KURATOR

Kandidati ose kandidatët, në rastin e një grupi kuratorial:

- mund të jenë shtetas shqiptarë ose të huaj, me rezidencë në Shqipëri ,ose jo;
- duhet të kenë njohuri të konsiderueshme mbi zhvillimet në fushën e krijimtarisë bashkëkohore në fushat e artit pamor në Shqipëri, duke përfshirë ato më të fundit;
- duhet të kenë një profil ndërkombëtar dhe të kenë përvojë në realizimin e projekteve të rëndësishme në fusha si hulumtim dhe publikim, ekspozita, etj.

Kandidati ose kandidatët e suksesshëm duhet të marrin përsipër të:

- mbajnë lidhje me stafin përgjegjës në Ministrinë e Kulturës dhe stafin e Bienales së Venecias me qëllim përmbushjen e të gjitha kërkesave;
- koordinojnë të gjitha aspektet logjistike të realizimit të Pavijonit të Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës;
- mbajnë lidhje me donatorë të mundshëm dhe të bashkëpunojë me galeri, muze apo koleksionistë për të ndihmuar mbulimin e kostove të pavionit.
- ideojnë dhe menaxhojnë katalogun zyrtar të Pavionit të Shqipërisë;
- ideojnë dhe menaxhojnë materialin publicitar të nevojshëm dhe të koordinojnë me personin përgjegjës për komunikimin për përgatitjen e eventeve në mënyrë që të krijohet maksimumi i interesit.

Thirrja mbulon të gjitha praktikat në fushën e arteve pamore, duke përfshirë më aktualet.

KRITERET E PROJEKTit

Projekt-propozimet e paraqitura duhet të konsistojnë në:

- prezantimin e konceptit qendror të Pavijonit të Shqipërisë *(jo më shumë se 150 fjalë)*;
- shtjellimin e tematikave të ndryshme që lidhen me këtë koncept dhe rëndësinë e tyre përsa i përket problematikave aktuale të shoqërisë shqiptare dhe/ose asaj globale *(jo më shumë se 300 fjalë)*;
- prezantimin e artistit/artistes dhe veprës së tyre ndër vite *(jo më shumë se 150 fjalë)*;
- përshkrim i punës/punëve që do të ekspozohen në kuadrin e Pavijonit *(jo më shumë se 150 fjalë)*
- një argumentim se pse artisti/artistët dhe punët e zgjedhura përshtaten me konceptin qendror të Pavijonit *(jo më shumë se 150 fjalë)*;
- plan/kalendar pune për realizimin e Pavijonit;
- draft-buxhet (nuk është e nevojshme që buxheti të jetë i detajuar në këtë pikë);
- CV të kuratorit/kuratorëve dhe artistit/artistëve;

Vini re!

Artisti ose artistët e propozuar duhet të:

- jenë të kombësisë shqiptare;
- kenë fituar një profil të rëndësishëm kombëtar;
- kenë përvoja të rëndësishme ndërkombëtare.

PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

Projekt-propozimet e paraqitura do të shqyrtohen nga një juri e përbërë nga 4 (katër) ekspertë të fushës, vendas dhe të huaj, dhe 1 (një) përfaqësues institucional (Ministria e Kulturës). Projekti fitues do të shpallet më datë 20 tetor 2014.

Gjatë përzgjedhjes do të merren parasysh:

- karriera e kuratorit/kuratorëve dhe artistit/artistëve;
- kapaciteti i tyre për të ndërmarrë një ekspozitë ndërkombëtare;
- vlerat artistike të propozimit, ku një theks i veçantë to t'i vihet forcës konceptuale dhe evokative të propozimit;
- përshtatshmëria në kuadrin e Bienales së Venecias;
- qëndrueshmëria financiare dhe logjistike në kontekstin e burimeve në dispozicion;
- aftësia për të përfshirë partnerë të jashtëm financiarë dhe mediatikë.

**Projekti-propozimet duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike në anglisht dhe shqip në adresën e e-mailit:
biennale_venecia2015@kultura.gov.al**

Projekt-propozimet duhet të dorëzohen gjithashtu me postë ose dorazi në adresën e mëposhtme:

**Ministria e Kulturës
Rruga e Kavajës Nr. 1
1001
Tiranë
Shqipëri**



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS